

Nëntor 2023

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
89.	2.11.2023	Kërkesë për informacion në lidhje me: - Urdhrat e brendshëm të drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për “Përbërjen e Komisionit të marrjes në dorëzim” të prokurimeve me objekt: “Shërbimi Mirëmbajtësish të pajisjeve të instaluar në stacionet e monitorimit të	15.11.2023	Në vijim të kërkesës tuaj për informacion dhe dokumentacion, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Në përgjigje të kërkesës tuaj të mëparshme të datës 4.10.2023 , përmes së cilës është kërkuar: <i>-Ju lutem na vini në dispozicion, si Dokument, kontratat e shërbimit të lidhura nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit nga viti 2018 deri në vitin 2023 me objekt:</i> <i>a-`Për mirëmbajtjen e pajisjeve të monitorimit” (Shërbimi i pajisjeve të monitorimit të cilësisë së Ajrit Urban)</i> <i>b-Materiale dhe pajisje laboratorikë të shërbimit publik</i> <i>c-Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës</i> <i>d-Riparim sistemet e monitorimit ajrit</i> <i>-Ju lutem na vini në dispozicion edhe informacion dhe dokumentet për çdo shtese kontrate që mund të jetë bërë në kontratat fillestare</i> - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit pas shqyrtimit të kërkesës tuaj ka vlerësuar se ky informacion përbën një informacion publik, për sa kohë që ka të bëjë me menaxhimin e fondeve publike, si dhe ka vendosur vënien e tyre në dispozicion edhe pa patur një kërkesë të arsyetuar, referuar ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar.	Përfunduar	0

	cilësisë se ajrit urban....” 2- Te na vihet ne dispozicion dokumentet e urdhrave te brendshëm te drejtorit te AKM-se për përbërjen e komisioneve qe kane ndjekur kontratat për vitet 2018, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 - me objekt: “Shërbimi Mirëmbajtjes se pajisjeve te instaluara ne stacionet e monitorimit te cilësisë se ajrit urban....” 3- Kërkesë e njëjte për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe		Ndërsa, sa i përket kërkesës tuaj për vënie në dispozicion të Urdhrave të Brendshëm, të sipërcituar, ju sqarojmë se këto janë akte nënligjore me karakter të brendshëm, përmes të cilëve janë ngritur grupet e punës, me anëtarë përbërë punonjës të MTM dhe AKM, të cilët kanë ndjekur procedurat, në vijim të lidhjes së kontratave të cilat janë vendosur në dispozicionin tuaj, bazuar në legjislacionin përkatës të prokurimeve. Bazuar në germën d, të nenit 28, të Kreut IV, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, përcaktohet se: <i>d) urdhri, që është akti nënligjor i Kryeministrit, i ministrit ose drejtuesit të institucionit qendror, në varësi të Kryeministrit ose ministrit, që ka karakter të brendshëm, që mund të vendosë rregulla sjelljeje, të përgjithshme, ose mund të rregullojë një marrëdhënie konkrete.</i> Gjithashtu, emrat e anëtareve të caktuar nëpërmjet urdhrave, të kërkuar nga ana juaj, përbëjnë të dhëna personale dhe mbrohen nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.		
--	--	--	--	--	--

		Agjencinë Kombëtare te Mjedisit: Ju lutem na vini ne dispozicion si dokumente fizike kontratat e lidhura nga MTM dhe AKM nëpërmjet tenderave publike me objekt: “Blerje reagentesh” “Blerje pajisje laborator” “blerje materiale laboratorike”. 4- Për AKM-ne: Urdhrat e brendshëm te drejtorit te Agjencisë Kombëtare te Mjedisit për “Përbërjen e Komisionit te marrjes ne dorëzim” te prokurimeve me				
--	--	--	--	--	--	--

		objekt: “Blerje reagentesh” “Blerje pajisje laboratori” “blerje materiale laboratorike”.				
90.	2.11.2023	Kërkesë për Informacion në lidhje me:një punim mediatik që do të realizohet në televizionin MCN ku kërkesi punon si gazetar. Materiali i llojit kronikë e zgjeruar, me objektiv menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Konkretisht: 1- Sa mbetje gjenerohen në Shqipëri nëpërmjet inceneratorëve? Si bëhet	15.11.2023	Në lidhje me informacionin mbi pikat fundore te trajtimit te mbetjeve, ju bëjmë me dije se ky informacion gjendet ne Raportin e Gjendjes se Mjedisit 2022, kapitulli Mbetjet, publikuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Ky informacion është i aksesueshem edhe ne Raportin e Gjendjes se Mjedisit 2022, publikuar nga AKM dhe ne faqen zyrtare te saj: www.akm.gov.al sipas linkut https://akm.gov.al/ova_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2022/. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është në proces evidentimi te vendepozitimeve te mbetjeve qe nuk përmbushin standardet, dhe rehabilitimin e tyre ne kuadër te projekteve te ekonomisë qarkulluese fale bashkëpunimit me KfW (Banka Gjermane për Zhvillim) dhe programit IPA III te Bashkimit Evropian me fokus menaxhimin e integruar te mbetjeve. Sa i takon pyetjeve te tjera në kërkesën tuaj, ju bëjmë me dije se në baze të Vendimit nr. 112, datë 2.03.2022 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit” nuk janë fushë përgjegjësie e MTM.	Përfunduar	0

		menaxhimi i tyre? 2-Sa prej inceneratorëve funksionojnë? Cilët? Cilat funksione kryejnë? 3-Sa landfille ka në vend? 4-Sa fusha mbetjesh nuk i plotësojnë standardet?				
91.	6.11.2023	Kërkesë për informacion ne lidhje me: sasinë e mbetjeve te importuara ne Shqipëri ne vitin 2012 (plastik, skrap)? Gjithashtu te dhëna ne lidhje me sasinë e importit ne vitin 2022 te disa tipave te metalit skrap qe pushojnë se qeni mbetje?	15.11.2023	- Sasia e mbetjeve e importuar ne vitin 2012 mund të gjendet duke ju referuar Raportit te Gjendjes se Mjedisit të vitit 2012, te publikuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe ne faqen zyrtare të saj: https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/ . - Sasia e importit ne vitin 2022 te disa tipave te metalit skrap qe pushojnë se qeni mbetje - mund te gjendet duke ju drejtuar Drejtorisë se Përgjithshme te Doganave si institucioni qe kontrollon importin e mallrave që hyjnë ne vend.	Përfunduar	0
92.	7.11.2023	Kërkesë për informacion në	14.11.2023	Deleguar te Agjencia Kombëtare e Mjedisit.	Përfunduar	0

		lidhje me: Ushtrimin e aktivitetit të ***** ne territorin e Bashkisë Krujë. Kopje të lejes së ushtrimit të aktivitetit për vitin 2023? A dispononi një raport të ndikimit në mjedis nga ushtrimi i aktivitetit të *****? Nëse po, na e vini në dispozicion. Kush e monitoron ndikimin në mjedis të *****? Sa është taksa e ndikimit në mjedis që *****				
--	--	--	--	--	--	--

		i paguan qeverisë/Bashkia Krujë?				
93.	8.11.2023	Kërkesë për informacion në lidhje me: Aktin nëpërmjet te cilit Ministri i Mjedisit dhe Turizmit ka miratuar modelin e kontratës se parashikuar nga Udhëzimi Nr. I, Date 9.6.2016 "Për rregullat, procedural e kërkimit, te shqyrtimit e te miratimit te kërkesave për dhënie ne përdorim te fondit pyjor dhe kullor publik".	15.11.2023	Kontrata tip për dhënien në përdorim me kontrate qiraje e fondit pyjor/ kullosor publik e miratuar është e vitit 2011 dhe referencat janë për drejtorinë e shërbimit pyjor dhe subjektet. Pavarësisht kësaj, kushtet, objekti, përcaktimet, janë të njëjta edhe sot, dhe përdoret nga strukturat e shërbimit pyjor ne bashki duke ndryshuar emërtesat dhe bazën ligjore. Bashkëlidhur gjeni urdhrin nr. 407, datë 20.09.2011, Për “Miratimin e kontratës tip dhe formatit te saj, që do të lidhet ndërmjet drejtorisë së shërbimit pyjor dhe subjekteve, për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar”.	Përfunduar	0

94.	8.11.2023	Kërkesë për informacion ne lidhje me: Sipas Nenit 35 te Ligjit Nr. 93/2015, vënia ne dispozicion e pasurive te paluajtshme shtetërore për projekte ne zona me përparësi zhvillimin e turizmit mund te behet për një afat deri ne 99 vjet edhe nëpërmjet Kontratës Simbolike 1 Euro. Vendimi Nr.162/2016 “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në	20.11.2023	Në vijim të kërkesës së përsëritur nga ana juaj, ju informojmë: se në mbështetje të Nenit 35 të Ligjit Nr. 93/2015, për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit dhe Vendimit Nr.162/2016 “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka iniciuar për miratim asnjë vendim te Këshillit te Ministrave për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore për projekte investimi në zona me përparësi zhvillimin e turizmit.	Përfunduar	0

		zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”, në lidhje me tarifat që aplikohen, nëpërmjet parashikimit në Kreun III, referon në kuadrin ligjor në fuqi për shfrytëzimin dhe përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore, në varësi të llojit të tyre. Duke qene se përgjigjja juaj sqaron vetëm vënien ne dispozicion nëpërmjet Kontratës Simbolike 1 Janë lidhur, në bazë të Nenit 35 të Ligjit Nr.				
--	--	---	--	--	--	--

		93/2015 “Për turizmin”, kontrata për vënien në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, me afat deri në 99 vjet, mes organeve të qeverisjes qendrore/vendor e dhe personave fizikë ose juridikë, për ushtrimin e veprimtarive turistike kundrejt një çmimi te ndryshëm nga ai simbolik prej 1 euro, pra kundrejt një çmimi tjetër te përcaktuar ne varësi te llojit te pasurisë se paluajtshme				
--	--	--	--	--	--	--

		shtetërore dhe kuadrit ligjor në fuqi? Nëse po, në cilat zona me përparësi zhvillimin e turizmit ushtrojnë veprimtarinë e tyre subjektet e përmendur më lart? Nëse po, cili është afati për secilën kontratë të nënshkruar?				
95.	10.11.2023	Kërkesë për informacion në lidhje me: Kërkojmë të na vendoset në dispozicion kopja e planit të menaxhimit për Parkun Natyror Ligeni i Ulzës.	10.11.2023	Deleguar te Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.	Përfunduar	0
96.	10.11.2023	Kërkesë për informacion në lidhje me:	21.11.2023	Referuar kërkesës suaj për informacion të gjitha subjektet të pajisur me leje mjedisi Kod III.1.B, Kod III.1.C dhe licencë nënkategorisë III.2.B aplikojnë sipas ligjit Nr. 10081 datë 23.02.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH" i ndryshuar,	Përfunduar	0

		Referuar komunikimit tonë të mëparshëm, ju shkruani se subjektet e listuara janë të licensuara gjatë periudhës 2015 – 2023 për transferimin e mbetjeve. Ju lutem të më vendosni në dispozicion kompanitë e licensuara për ASGJESIMIN (jo transferimin) e medikamenteve të skaduara.		VKM-së Nr. 538 datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta" i ndryshuar. Lejet dhe licencat janë të publikuara nga në regjistrin kombëtar të licencave, autorizimeve lejeve të lëshuara nga QKB-ja.		